



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 8 KORRIK 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI

(Seanca filloi në orën 17:00)

Rendi i ditës:

1. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*.
2. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe i propozimit të Komisionit për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar, bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta. *(nenet 48 dhe 112 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Raporti i Komisionit përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Diskutime *(130 minuta debati – 70 minuta shumica parlamentare – 60 minuta opozita parlamentare)*

Koha e votimit

Gramoz Ruçi – Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Këshilli i Ministrave ka depozituar 4 projektligje dhe materialet si gjithnjë do t'i gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit.

Para se të kaloj në çështjet e rendit të ditës, po ju paraqes një përshkrim të shkurtër të procedurës parlamentare që ka ndjekur kërkesa për shkarkimin e Presidentit të Republikës, sipas nenit 112 të Rregullores së Kuvendit.

Siç jeni në dijeni, në datën 17 qershor 2019, një grup deputetësh të maxhorancës, 55 gjithsej, në mbështetje të nenit 90, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 112 të Rregullores, kanë depozituar në Kuvend kërkesën për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rëndë të Kushtetutës.

Në respektim të nenit 112, pika 1, të Rregullores është njoftuar menjëherë Kuvendi në seancë plenare dhe, gjithashtu, është njoftuar edhe Presidenti i Republikës. Po në respektim të Rregullores, neni 112, pika 2, kërkesa e bërë i është përcjellë menjëherë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si komision përgjegjës për të shqyrtuar çështjen në fjalë.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka shqyrtuar kërkesën në datat 19, 24 dhe 26 qershor 2019 dhe pas shqyrtimit brenda 15 ditëve ka depozituar më 1 korrik 2019 raportin që keni të gjithë në tavolinat e punës.

Në respektim të nenit 112, pika 3, të Rregullores, sipas së cilës Kuvendi zhvillon debat në seancë plenare jo më vonë se 7 ditë nga data e paraqitjes së raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në datën 1 korrik 2019 është mbledhur Konferenca e Kryetarëve, e cila vendosi mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare, sot në datën 8 korrik, ora 17:00, dhe koha e debatit do të jetë gjithsej 130 minuta.

Fillojmë menjëherë me shqyrtimin e raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe propozimin e komisionit për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh, për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta.

Sipas Rregullores, neni 112, pika 3, shprehet komisioni përgjegjës. Në emër të komisionit fjalën e ka zoti Manja.

Zoti Manja, keni gjithsej 15 minuta në dispozicion.

Ulsi Manja – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Si kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut jam sot këtu përpara jush për të prezantuar në emër të komisionit raportin për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, është vënë në dijeni nga Kryetari i Kuvendi me shkresën nr. 2502/2, datë 17.06.2019, për depozitim të kërkesës së një grupi deputetësh “Për shkarkimin e Presidentit të Republikës” dhe në zbatim të nenit 112, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, u mbledh respektivisht në datat 19, 24 dhe 26 qershor 2019 për të shqyrtuar kërkesën e deputetëve.

Baza kushtetuese.

Kërkesa e paraqitur për shqyrtim është propozuar nga një grup prej 55 deputetësh, sipas përcaktimeve të nenit 90, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 112 të Rregullores së Kuvendit.

Procedura e shqyrtimit.

Komisioni i Ligjeve e nisi shqyrtimin e kërkesës së deputetëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës në mbledhjen e datës 19.06.2019 dhe në emër të grupit të deputetëve nismëtarë kërkesën në Komisionin e Ligjeve e prezantuan dy deputetë, respektivisht zoti Taulant Balla, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, dhe zoti Ervin Bushati, sekretar i këtij grupi.

Zoti Balla paraqiti përpara anëtarëve të komisionit rrethanat mbi të cilat bazohet kërkesa e deputetëve, duke argumentuar se akti i nxjerrë nga Presidenti i Republikës, dekreti nr. 11199, datë 10.06.2019 “Për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” është në kundërshtim të hapur me parimet kushtetuese të

një republike parlamentare, të funksioneve të Presidentit të parashikuara nga Kushtetuta dhe të funksionimit dhe të ushtrimit të sovranitetit të popullit.

Në përfundim të fjalës së tij, zoti Balla, në emër të grupit të deputetëve nismëtarë kërkoi nisjen e procedurave për shkarkimin e Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta, duke argumentuar edhe një herë në mënyrë të përmbledhur plotësimin e kushteve të parashikuara nga neni 90, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Pas pyetjeve dhe diskutimeve të anëtarëve të komisionit lidhur me kërkesën e deputetëve u vazhdua me kalendarin e punimeve të komisionit për shqyrtimin e kërkesës së deputetëve për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës, duke u caktuar si relatorë respektivisht nga Komisioni i Ligjeve deputetja Klotilda Bushka dhe zoti Adnor Shameti.

Bazuar në nenin 112, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, ku parashikohet: “Në rast se kërkohet nga Presidenti i Republikës për t’u shprehur në komision, komisioni është i detyruar ta dëgjojë atë, duke i lënë një kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe dhënien e sqarimeve”, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Ligjeve me shkresën nr. 2502/3, datë 19.06.2019, kam vënë në dijeni Presidentin e Republikës, zotin Ilir Meta lidhur me datën e mbledhjes së radhës së komisionit, për vijimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës së deputetëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës, me qëllim garantimin e të drejtës së tij për t’u dëgjuar në komision.

Shkresës së kryetarit të Komisionit të Ligjeve i është përgjigjur sekretarja e Përgjithshme e institucionit të Presidencës me shkresën nr. 1956/1, datë 22.06.2019. Në këtë shkresë, e cila përmban një gjuhë joetike, jozyrtare, ironike, fyese dhe aspak të denjë për institucionin që përfaqëson kreun e shtetit, ndaj deputetëve të Komisionit të Ligjeve dhe ndaj Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet sekretares së Përgjithshme Presidenti i Republikës dëshmoi qartazi se nuk kishte interes të dëgjohej gjatë shqyrtimit të kërkesës në Komisionin e Ligjeve.

Procedura e shqyrtimit të kërkesës së deputetëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës vijoi në dy mbledhjet e radhës së komisionit, sipas kalendarit, konkretisht në datat

24 dhe 26 qershor 2019. Komisioni ka konstatuar se Presidenti i Republikës së Shqipërisë në ushtrim të kompetencave të dhëna nga Kushtetuta, neni 92, germa “gj”, ka nxjerrë dekretin nr. 10928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”. Në bazë të këtij dekreti është caktuar si datë e mbajtjes së zgjedhjeve vendore në Republikën e Shqipërisë data 30 qershor 2019. Në përmbushje të këtij parashikimi ligjor kanë filluar të gjitha procedurat, sipas Kodit Zgjedhor, për bërjen të mundur brenda afateve kushtetuese dhe ligjore të procesit zgjedhor të zgjedhjeve të 30 qershorit 2019.

Konkretisht, në zbatim të këtij dekreti ishin ngritur komisionet e zonave të administrimit zgjedhor, neni 28 i Kodit Zgjedhor; ishte përgatitur dhe shpallur lista e zgjedhjeve, detyrim i nenit 56 të Kodit Zgjedhor; ishte kryer regjistrimi i partive politike, detyrim i nenit 64 të Kodit Zgjedhor; ishin depozituar listat e kandidatëve të partive politike, neni 67 i Kodit Zgjedhor, si dhe kishte filluar zyrtarisht fushata zgjedhore, si detyrim i nenit 77 të Kodit Zgjedhor. Ndërkohë që kishte filluar periudha zgjedhore, Presidenti ka nxjerrë dekretin nr. 11199, datë 10.06.2019, për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”. Sipas nenit 1 të këtij dekreti, shfuqizohet dekreti nr. 10928 i vitit 2018, duke anuluar kështu datën 30 qershor të vitit 2019, si datë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

Arsyet e dhëna nga Presidenti për anulimin e datës së zgjedhjeve kanë të bëjnë konkretisht me shqetësimin e thellë për situatën politike në vend, thotë Presidenti, nevojën për shtensionimin e situatës politike në vend, vetëdijes se në kushtet aktuale nuk do të siguroheshin zgjedhje të vërteta, demokratike, përfaqësuese dhe gjithëpërfshirëse, bindjen se kjo vendimmarrje në kushtet aktuale është mënyra e vetme për të ndihmuar në zgjidhjen e krizës së rëndë ku ndodhet vendi. Jepet argumenti se kjo vendimmarrje mbështetet në kompetencën që i jep neni 92, shkronja “gj” e Kushtetutës, si dhe preambula e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 3 e nenit 1, neni 3, pika 2 e nenit

4, neni 15, neni 45, pika 1 e nenit 86, pika 3 e nenit 88 dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si organi përgjegjës për organizimin, administrimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, nuk e mori në konsideratë për zbatim dekretin e Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve vendore dhe vijoi me procesin zgjedhor, duke arsyetuar se ky akt i Presidentit të Republikës është absolutisht i pavlefshëm, pasi ka dalë në kapërcim të kompetencave të Presidentit dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Sipas nenit 94 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera, përveç atyre të njohura shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligj. Akti që del në mungesë të kompetencës është nul dhe konsiderohet që nuk ka ekzistuar asnjëherë.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin e datës 13.06.2019, rezolutë për aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, bazuar në përgjegjësinë që i ngarkon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 1 të saj, ku shprehimisht thuhet: “Se Shqipëria është republikë parlamentare”, në respektim të parashikimit kushtetues se qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e peridioke dhe duke mbajtur parasysh rolin dhe kompetencat e Presidentit në një republikë parlamentare, mbështeti qëndrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vijimin e procesit zgjedhor dhe e inkurajoi këtë organ të vijojë të mbrojë pacenueshmërinë dhe të garantojnë vazhdimësinë e procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019, duke njohur si aktin e vetëm të ligjshëm dekretin e Presidentit nr. 10928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”.

Gjithashtu, në këtë rezolutë Kuvendi i Shqipërisë u bëri thirrje të gjitha organeve publike, që ngarkohen nga ligji me detyra në kuadër të mbarëvajtjes dhe organizimit të zgjedhjeve vendore të qershorit të vitit 2019, t'i konsiderojnë si inekzistent aktin e Presidentit, datë 10.06.2019 “Për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018” dhe të vijojnë me përmbushjen e detyrave, sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor, për të garantuar të drejtën

kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në pushtetin zgjedhor.

Po ashtu, Kolegji Zgjedhor, me vendimin e datës 24.06.2019, la në fuqi vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që rrëzoi kërkesën e Partisë së Unitetit Kombëtar për t'u çregjistruar nga zgjedhjet vendore të 30 qershorit.

Vendimi i Kolegjit Zgjedhor, në mënyrë të qartë, i dha përgjigje edhe debatit lidhur me paligjshmërinë e dekretit të Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve, duke e konsideruar atë nul dhe të pazbatueshëm.

Duke vlerësuar se me anulimin e datës së zgjedhjeve Presidenti ka kryer një shkelje të rëndë kushtetuese, një grup prej 55 deputetësh ka paraqitur një kërkesë për shkarkimin e Presidentit të Republikës, bazuar në nenin 90/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 112 të Rregullores së Kuvendit, që normojnë procedurën që ndjek Kuvendi për shkarkimin e Presidentit të Republikës. Ky grup deputetësh çmon se dekreti i Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve vendore është në kundërshtim të hapur me parimet kushtetuese të një republike parlamentare të funksioneve të Presidentit të parashikuara nga Kushtetuta dhe të funksionimit e të ushtrimit normal të sovranitetit të popullit.

Në arsyetimin e kërkesës së tyre deputetët nënvizojnë se Presidenti me aktin e tij ka cenuar rëndë parimin e ushtrimit të sovranitetit nga ana e popullit në kundërshtim me pikën 1 të nenit 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ka shkelur Kushtetutën dhe ka marrë, njëkohësisht, tagra të sovranit dhe të Kuvendit; është sjellë arbitrarisht me pushtetin përkundër natyrës së republikës parlamentare, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ka anuluar arbitrarisht datën e zgjedhjeve, në kundërshtim me germën “gj” të nenit 92 të Kushtetutës dhe neneve 8, 9, dhe 10 të Kodit Zgjedhor; ka cenuar parimin e periodicitetit të zgjedhjeve, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 1 dhe nenin 109 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ka cenuar parimin e ushtrimit të pushtetit në një shtet nga një qeverisje e dalë nga zgjedhje të lira, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 1 të Kushtetutës; ka cenuar parimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, në

kundërshtim me paragrafin e dytë të nenit 4 të Kushtetutës dhe nenin 4 të Kodit të Procedurës Administrative; ka nxjerrë një akt në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjet, si dhe ka cenuar parimin e të drejtës së qytetarëve sovranë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 45 të Kushtetutës.

Komisioni i Ligjeve shqyrtoi bazueshmërinë ligjore të kërkesës së paraqitur dhe çmoi se në aspektin ligjor dhe procedural kërkesa është në përputhje me nenin 90/2 të Kushtetutës dhe me nenin 112 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Komisioni vlerësoi se nga pikëpamja substanciale kërkesa e 55 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë për fillimin e procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 90/2 të Kushtetutës për të legjitimuar ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për të hetuar shkeljen e rëndë të kryer nga Presidenti i Republikës.

Pjesë e hetimit duhet të jetë edhe korrespondenca e Presidentit të Republikës me nr. 1956/1 prot, datë 22.06.2019 e Sekretares së Përgjithshme të institucionit të Presidencës.

Në përfundim të mbledhjes së datës 26.06.2019, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka miratuar me shumicë votash këtë raport, që unë po e paraqes sot këtu para jush dhe i ka propozuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për të hetuar shkeljen e rëndë të Kushtetutës nga ana e Presidentit të Republikës, konkretisht të nenit 90/2 të Kushtetutës, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 112 të Rregullores së Kuvendit.

Bashkëngjitur këtij raporti, është edhe projektvendimi për ngritjen e komisionit hetimor, së bashku me përbërjen përkatëse.

Shumë faleminderit, të nderuar kolegë!

Ju ftoj ta votoni raportin dhe ngritjen e komisionit hetimor.

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Manja!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E doni fjalën për procedurë?

Kujtim Gjuzi – Po, e kam për procedurë.

E para, keni planifikuar një distancë kohe të shkurtër dhe atje, ku regjistrojmë emrat për të

diskutuar, keni vendosur dy minuta për pjesën tjetër, që është jashtë grupeve parlamentare.

E dyta, do të desha, sepse ne jemi deputetë dhe, normalisht, do të shprehemi me votë këtu, që shkresa, e cila përmban denigrime, fyerje të dala nga institucioni i Presidencës, dhe është mjaft e rëndë, do t'i lutesha kryetarit të komisionit, nëse është mundësia, dhe unë them që duhet të jetë, që ne deputetët duhet ta kemi përpara.

Faleminderit, zoti Kryetar!

Gramoz Ruçi – Të nderuar kolegë deputetë,

Sipas Rregullores së Kuvendit, sot është lënë data për të debatuar për këtë çështje dhe është përcaktuar edhe koha për debat, e cila është 130 minuta, ku maxhoranca ka 70 minuta, Grupi Demokrat ka 20 minuta, Grupi i Pavarur ka 10 minuta, partitë e djathta kanë 10 minuta, si dhe deputetët e pavarur kanë 22 minuta. Kështu që nuk është faji i kohës që nga maxhoranca, e cila ka 70 minuta, vendosen vetëm pesë deputetë dhe nga deputetët e pavarur vendosen tetë deputetë, pra dyfishi, ose anasjelltas me Grupin Demokrat ose Grupin e Pavarur e të tjera.

Vazhdojmë me debatin. Do t'u lutesha kolegëve që të respektojnë kohën para se të merrni fjalën.

Fjalën e ka Kryeministri, zoti Edi Rama, që ka 40 minuta në dispozicion. Të përgatitet deputeti Arben Elezi.

Edi Rama – “Kurrë mos e ndalo kundërshtarin që po gabon”, – thotë Napoleon Bonaparti, por sot ne nuk jemi mbledhur këtu të ndalojmë kundërshtarin tonë.

Si kundërshtar i kësaj shumice qeverisëse, Ilir Meta nuk duhet ndaluar në qorrmarrshimin e tij vetëshkatërrues, sa unikal, aq edhe vërtet të trishtueshëm në historinë politike të këtij vendi.

Politikisht, ai na e bën shumë më të lehtë pozicionin tonë në sytë e popullit, sepse njerëzit e shikojnë tanimë krejt lakuriq të vërtetën e armiqësisë së egër të Ilir Metës ndaj shumicës sonë qeverisëse. Është një armiqësi e ushqyer nga dëshpërimi prej disfatës së turpshme të planit antikombëtar të hedhjes në erë të zgjedhjeve, që synonte si pasojë imediate pengë marrjen e drejtësisë dhe pengimin, mundësisht në pafundësi, e çeljes së negociatave me Bashkimin Europian. Për këtë do të flas pak më vonë.

I kam ndjekur ndërkohë me një ndjenjë mëshire budallallëqet e fallxhore Monikë dhe akrobacitë e artistit Lul, së bashku me mufkat e haxhiut Ilir, që nga shfaqësimet e hatashme për disfatën e tyre, deri te fajësimet e dëshpëruara në adresën tonë për pjesëmarrjen e ulët në zgjedhje dhe me raportin paraprak të misionit të ODIHR-it.

Fatmirësisht, e kam thënë disa herë gjatë fushatës së lufta e tyre për të prishur zgjedhjet me dhunë do të rezultonte një vrimë në ujë, por kjo nuk do t'i pengonte ata të shpallnin fitoren e radhës. E kam ditur se do t'i numërojnë si mbështetës të revolucionit imagjinar shqiptarët jashtë shtetit, shqiptarët në shtëpi, shqiptarët në plazh, por e vetmja gjë që nuk kam menduar është se do t'i numëronin gabim. Estradë hesapi, $7 \times 7 = 42$.

Nuk ka më keq për humbësit sesa të sillen si fitimtarë dhe nuk ka më mirë për fituesit sesa humbësit, që nuk duan ta kuptojnë pse kanë humbur. Premisë e sigurt që fituesit të vazhdojnë të fitojnë dhe humbësit të vazhdojnë të humbasin.

"85% e popullit refuzoi Ramën", thonë të shkretët. Këta thonë se të gjithë shqiptarët kanë ikur nga Shqipëria, por kjo nuk i pengon t'i llogarisin të gjithë, që nga të ikurit e ambasadave në korrikun e '90-ës, si prezentë në Shqipëri në 30 qershorin e fundit.

Janë po këta që e kundërshtojnë denbabaden përfshirjen e votës së emigrantëve në Kodin Zgjedhor. Me këtë rast përfitoj të ritheksoj bindjen tonë se emigrantët duhet ta kenë të drejtën e votës duke filluar nga zgjedhjet e ardhshme dhe, duan apo nuk duan udhëheqësit e opozitës rrugore, ne do ta përfshijmë votën e emigrantëve në Kodin Zgjedhor. Uroj edhe me dakordësinë e opozitës parlamentare!

Sidoqoftë, e vërteta e thjeshtë është se pjesëmarrja në zgjedhjet e 30 qershorit ka tejkaluar çdo pritshmëri tonën në atmosferën mizerabël që u zhvilluan këto zgjedhje. Ne kemi marrë një përqindje më të lartë votash sesa kishte koalicioni fitues që qeverisi Shqipërinë, në vitin 2015, me vetëm 19,7%. Kemi marrë po ashtu një numër shumë më të madh votash për kandidatët sesa pritshmëria jonë më optimiste, nga një garë ku gjysma e tyre nuk kishin kundërshtar. Krahastuar me 4 vjet më parë, kur ishim me kandidatë të përbashkët me LSI-në, ky numër

është 4% më i ulët. Po të kishte qenë një garë normale, me kundërshtarë në çdo bashki dhe pa presionin e lartë kriminal me muaj të tërë e deri natën e fundit mbi zgjedhësit, pa diskutim që kjo përqindje do të ishte dukshëm më e lartë sesa ajo e vitit 2015.

Ta lexosh si refuzim popullor ndaj meje, ndaj nesh, përqindjen krejt normale të pjesëmarrjes në këto zgjedhje të bombarduara me kërcënime e ta shikosh rezultatin tonë të këtyre zgjedhjeve si tkurrje elektorale të shumicës qeverisëse, do të thotë jo thjesht të mos dish çfarë flet, por të mos kuptosh se çfarë vjen më pas.

Në fakt, zhvillimi i zgjedhjeve, rezultati ynë, por edhe analfabetizmi politik dhe verbëria kronike e udhëheqjes opozitare e tregojnë që sot pse ajo opozitë nuk ka asnjë shans rikthimi te fitorja, zero, në zgjedhjet e vitit 2021.

E pangushëllueshme është gjendja e përcartjes së tyre edhe kur thonë se raporti paraprak i misionit të ODIHR-it ka konfirmuar opinionet e opozitës bojkotuese dhe të Presidentit protestues për këto zgjedhje. Në fakt, raporti paraprak ka pasqyruar me korrektësi një proces zgjedhor krejt anormal, ku duhet theksuar se anormaliteti i sjelljes dhe shkelja e rëndë e Kushtetutës nga ana e Presidentit kanë ndikuar në dreqosjen si s'ka më keq të procesit, i cili ishte për të ardhur keq edhe pa salton mortale të Ilir Metës.

Mungesa e gjerë e besimit të publikut në procesin elektorale, e nënvizuar në raportin paraprak, është një fakt i pakontestueshëm, por është krejt e qartë se ka ardhur si pasojë e agresionit politik dhe kërcënimit të vazhdueshëm të dhunës mbi krejt procesin, si dhe, padyshim, për shkak të ndërhyrjes së dhunshme të Ilir Metës në proces me antidekretin e tij skandaloz.

Si mund të mos cenohej gjerësisht besimi të zgjedhjet nën shantazhin e përmuajshëm, përditshëm dhe të përnatshëm për mosmbajtjen e tyre? Ai shantazh dekurojoi dhe mpiu për një kohë të gjatë edhe vetë strukturat tona elektorale në territor, lëre pastaj simpatizantin politik, apo qytetarin e pavendosur.

Si mund të ruhej i patronditur thellësisht besimi te ky proces, pas rrëmujave logjike dhe fizike që provokoi Ilir Meta me zhdukjen e befasishme të datës së zgjedhjeve apo me

rishfaqjen e saj si një provim antikushitetues vjeshtë?!

Dizekuilibri politik i administratës zgjedhore dhe nevoja për depolitizim të komisionit të votimit janë, gjithashtu, fakte të pakontestueshme të raportit. Dizekuilibri politik ishte reflektimi i drejtpërdrejtë i absurditetit të këtyre zgjedhjeve të bojkotuar nga opozita kryesore, ndërsa politizimi i komisioneve është një fakt i njohur botërisht dhe i nënvizuar edhe në raportet e mëparshme të ODIHR-it.

Dua të jem shumë i qartë edhe në këtë pikë sot. Kjo ishte hera e fundit që zgjedhjet administrohen nga partitë politike. Do të duan apo nuk do të duan bojkotuesit e këtyre zgjedhjeve, që ikën, ne do ta depolitizojmë administratën zgjedhore, besoj edhe me mbështetjen e opozitës parlamentare.

Misioni i ODIHR-it ka vërejtur se ka pasur probleme me cilësinë e procesit të verifikimit të të dhënave të adresave. Edhe ky aspekt kërkon vëmendjen e Komisionit të Reformës Zgjedhore për çdo përmirësim të mundshëm të këtij procesi, por raporti e shpreh qartë se në masë të madhe, kjo është shkaktuar nga fakti se listat e zgjedhësve, që u afishuan fillimisht pranë KZAZ-ve dhe QV-ve, u hoqën nga bashkitë e opozitës në mes të procesit zgjedhor. Ju kujtohet besoj si në incertinë e revolucionit imagjinar, kryebashkiakët revolucionarë u lëshuan kundër listave dhe shkollave në mbrojtje të imagjinatës revolucionare të zotit President. Si rrjedhojë, qorrat e çartur të revolucionit e kufizuan mundësinë e zgjedhësve për të verifikuar të dhënat e tyre.

Ah, po, ka edhe një pikë tjetër, ku janë kapur si i mbytur pas fijos së barit dhe pas një shprehjeje të raportit, ku thuhet se KQZ-ja e interpretoi ligjin zgjedhor në mënyrë kreative. E vërtetë është edhe kjo. Por po aq e vërtetë sa edhe fakti që përballë dëshpërimit kreativ të frontit të së keqes së këtyre zgjedhjeve, KQZ-së nuk i mbeti rrugë tjetër, veçse të rezistonte, duke mbrojtur frymën e Kushtetutës dhe të Kodit Zgjedhor, për të shpëtuar zgjedhjet nga shkatërrimi i paralajmëruar. Në kushtet kur tanimë 30 qershor i ka mbijetuar agresionit më të egër dhe më të turpshëm antidemokratik që politika e 30 vjetëve të fundit ka ndërmarrë ndonjëherë kundër interesit publik, lirisë së zgjedhjeve dhe të drejtës së zgjedhjeve, si dhe

objektivit kombëtar të integritetit të Shqipërisë në familjen europiane, Ilir Meta, siç e thashë që në fillim, do të ishte politikisht për ne një kundërshtar që s'duhet ndaluar të gabojë më tutje.

Ashtu i dizekuilibruar prej frikës nga drejtësia, i çoroditur prej disfatës së operacionit antikombëtar, që bashkëudhëhoqi me 3 kalorësit e tjerë të apokalipsit imagjinar, hakërrues dhe qesharak njëkohësisht, në pafuqinë e tij, ai është sot, faktikisht, një aset i vyer politik i kësaj shumice qeverisëse. Me atë lloj figurine kërcënuese në Presidencë, edhe më të pakënaqurit ndaj nesh do të trembeshin ta çonin votën gjetkë pas dy vjetësh. Ndërsa ne do të ishim shumë më të tolerueshëm me gabimet tona, pasi, krahasuar me atë shëmbëlltyrë kuptimplotë të destruktivitetit opozitar në Presidencë, do të dukeshim lule në sytë e gjykesit popull.

Mirëpo ne jemi të ndaluar ta përdorim kryetarin e shtetit si një gogozhel për të trembur zgjedhësit e pakënaqur ndaj nesh dhe jemi të detyruar ta ndalojmë Ilir Metën të gabojë më tej, sepse për ne dinjiteti i këtij shteti është më i rëndësishëm sesa çdo interes partiak apo kalkulim elektoral.

Ilir Meta duhet hetuar dhe ndëshkuar deri në fund nga ky Kuvend dhe reagimi ynë ndaj tij, si deputetë të këtij Kuvendi, duhet të jetë frontal, përtej dallimeve tona politike dhe në emër të Kushtetutës, demokracisë parlamentare dhe vetë dinjitetit të shtetit shqiptar. Në këtë pikë, graviteti i parimeve themelore të Kuvendit, që na mbledh si përfaqësues të popullit, është një emërues që duhet të na bashkojë natyrshëm në vendim dhe në veprim, pavarësisht çdo interesi politik që natyrshëm na ndan.

Ilir Meta nuk është më thjesht kundërshtari i njohur i qeverisë. Ai sot është armiku i hapur i vetë Kushtetutës së Shqipërisë; nuk është më thjesht frymëzuesi i ofensivës destruktive kundër zgjedhjeve dhe drejtësisë, ai sot është armiku i deklaruar i vetë parlamentit të Shqipërisë; nuk është më thjesht politikani i frikësuar deri në palcë nga reforma në drejtësi, ai sot është vetë shëmbëlltyra e tërbimit të të tremburve nga drejtësia, i cili edhe me shtrirjen e rrezes së agresionit të tij mbi miqtë dhe partnerët amerikanë dhe europianë na turpëron të gjithëve,

ne këtu si deputetë, edhe ty, si qytetar, si popull, si shtet.

Si mund të ketë Shqipëria e sotme, Shqipëria në NATO, Shqipëria kandidate për në Bashkimin Europian, një kryetar shteti që duket si një aktor komik që imiton Presidentin e Republikës; një kryetar shteti që, kur flet seriozisht, të bën për të qeshur dhe, kur flet me të qeshur, të bën për të qarë; një kryetar shteti, që e parafytyron veten si një Vojo Kush me kravatë mbi çatinë e ambasadës së Bashkimit Europian dhe që e imagjionin ambasadën amerikane si topin, ku vendos gjoksin e tij prej Mic Sokoli me kostum banjoje?!

Si mund të ketë Shqipëria e sotme një kryetar shteti, që arrin e thotë në konferencë për shtyp se është gati të përballet me testin e shëndetit mendor, gjë që, në fakt, nuk ia ka kërkuar askush, edhe pse askush nuk ka mbetur pa pyetur veten: a mos vallë ky njeri është realisht i ikur nga mendja e kokës?! Por kjo pyetje nuk të çon askund, madje mund të çojë në drejtim krejt të gabuar. Sëmundja e vërtetë e këtij kreu shteti, i futur në qorrsohakun e inatit pa krena, është ajo e personazhit të Dostojevskit, i cili gënjen veten për të gënjer të tjerët. Si i tillë, ai nuk është gënjeshtar, por është i sëmurë.

Dostojevski ka thënë: “Sfida më e madhe morale në jetë nuk është të mos gënjesh të tjerët, por të mos vetëgënjesh, sepse, duke u vetëgënjer, njeriu vjen në një pikë (ja kështu si Ilir Meta) që nuk e kupton më se ku mbaron përjetimi i botës brenda kokës së vet dhe ku fillon bota reale jashtë rradakes së tij, çka shkakton një çoroditje ekstreme të marrëdhënieve midis individit të vetëgënjer dhe gjithë dynjallëkut rreth e rrotull”.

Por nëse Ilir Meta mund t’ia lejojë vetes të ngatërrojë të gjithë dynjanë me përçarjen e tij mes imagjinatës së harbuar nga frika e njeriut, që shkon për në Tropojë dhe i duket sikur kalon nga burgu i Spaçit dhe realitetit politik e shoqëror, që i përplas në sy fakte, ndodhi, ndaj të cilave ai reagon me akte antikushetuese dhe me shfaqje komike, poshtërimi të institucionit të Presidentit të Republikës, ky parlament nuk mund t’ia lejojë vetes mbylljen e syve përballë këtij burimi destabiliteti politik, institucional, rrezikshmërie shoqërore dhe komedie ndërkombëtare.

Ilir Meta, ç’është e vërteta, e ka shkelur Kushtetutën më shumë se një herë. Më shumë se

një herë ai ka tentuar destabilizimin e qeverisë, duke penguar arbitrarisht apo duke refuzuar harbutërisht dekretimin e ministrave. Më shumë se një herë ai e ka cenuar autoritetin e Kuvendit të Shqipërisë, duke komentuar politikisht apo duke kthyer mbrapsht papërgjegjshmërisht ligjet e miratuara nga ky parlament, pa llogaritur më herët, kur e ka fyer këtë parlament, duke e quajtur ilegjitim apo kur e ka kërcënuar, duke lënë të kuptohet se edhe mund ta shpërndajë fare. Më shumë se një herë ai e ka prishur ekuilibrin e figurës së Presidentit të Republikës dhe ka dalë nga roli kushtetues i tij, duke luajtur role dhe lojëra, që kurrë një President nuk ia ka lejuar vetes, jo vetëm këtu në Shqipëri, por në tërë historinë e demokracive parlamentare.

Aq larg ka shkuar në vandalizmat e tij kundër arsyes shtetërore ky farë Presidenti, sa edhe vetë paraardhësi i tij, një rreshter partiak, me mendje të vobektë, duket sot si Jefferson-i, krahasuar me Ilir Metën.

Por këtë herë, Ilir Meta e ka tejkaluar edhe vetveten, bashkë me cakun e fundit të mundësisë sonë për ta duruar, pa reaguuar institucionalisht për tejkalimin e tij. Këtë herë ai ka luajtur deri në fund me zjarrin dhe ka bërë deri në fund gjithçka, që plani i shëmtuar, i egër, i paturpshëm dhe i pafalshëm i zjarrvënies së Shqipërisë të mos dështonte.

Ilir Meta ndërhyri brutalisht në mes të fushatës zgjedhore me një antidekret çmendurak, një molotov zemërimi politik dhe lajthitjeje institucionale për të ushqyer zjarrin në fikje të protestave të dëshpërimit të verbër opozitar. Me antidekretin e tij ai nxiti përhapjen e dhunës në territoret e bashkive të drejtuara nga opozita dhe frymëzoi aktet e vandalizmit ndaj infrastrukturës zgjedhore që nga djegiet kriminale të shkollave, deri te kryengritja groteske e bravave.

Ai u kthye nga Presidenti problematik i Shqipërisë, në tribunin patetik të lëvizjes haxhiqamiliste kundër zgjedhjeve, duke fyer edhe miqtë e Shqipërisë me reagimet e tij dumbabiste ndaj përfaqësive diplomatike në Shqipëri dhe me letrat e tij qesharake drejtuar autoriteteve të larta ndërkombëtare, si të ishte “Qytetari dixhital”, që i ankohet doktorit për vjedhjen e mbathjeve të detit nga narkopolumbarët e Gjirit të Lalzit.

Shkarkimi nga detyra e lartë e kreut të shtetit, e këtij personazhi, i cili risolli në skenën

e historisë sonë si president Haxhi Qamili, me vulën e tij proverbiale të kompanisë së eksport-importit të kafesë, është një lëvizje me detyrim-përcaktim i këtij Kuvendi dhe është një detyrim i çdo deputeti, që nuk e ka harruar betimin përpara Kuvendit.

Ilir Meta nuk e ka mbushur kupën, por e ka derdhur dhe vazhdon ta derdhë atë përditë, duke na dhënë çdo ditë një arsye për të ndier keqardhje për të si njeri, të neveritur me të si politikanë dhe për t'u ndier të alarmuar prej tij si mbajtësi i vulës së lartë, që e ka humbur të drejtën të jetë.

Por, natyrisht, ndryshe nga Ilir Meta, që i ka kërcyer shtetit përsipër, si të ishte një tank armik dhe që e përdor firmën si bombë për ta hedhur atë në erë, ne nuk mund ta përdorim fuqinë absolute të Kuvendit të Shqipërisë mbi Presidentin e Republikës, si topin e Mato Grudës mbi sarajet e Mere Fizit.

Me zakon, Ilir Meta duhej shkarkuar që ditën kur u hodh si raketë antiamerikane nga tava e koranit të Faros në Pogradec drejt avionëve imagjinarë të juntës ushtarake amerikano-shqiptare, që e çuan mbi pallatin presidencial në Tiranë, por me ligj ai mund të shkarkohet vetëm pasi Komisioni Hetimor Parlamentar, që do të votojmë sot, të kryejë detyrimin kushtetues të hetimit të fakteve, të dëgjimit të dëshmimeve përkatëse dhe të raportimit përpara Kuvendit të përfundimit të hetimeve për shkelje të rëndë të Kushtetutës.

Ndryshe nga Ilir Meta, i cili zgjodhi shembullin e forcës destruktive për interesa politike dhe vetjake, ne kemi zgjedhur forcën e shembullit ligjor dhe demokratik në mbrojtje të interesit kombëtar dhe dinjitetit të shtetit shqiptar. Krenarë dhe të palëkundur për këtë zgjedhje të drejtë dhe të qartë, ne do të respektojmë, edhe në këtë rast, deri në fund, Kushtetutën, ligjin dhe shtetin.

Në mbyllje të kësaj fjale, dua t'u bëj apel të gjithë deputeteve të votojnë ngritjen e komisionit të posaçëm hetimor, pikërisht në emër të interesit kombëtar dhe dinjitetit të këtij Kuvendi. Po ashtu, i bëj një thirrje publike Ilir Metës, që të reflektojë, ta mbledhë veten, që e ka shpërndarë, dhe ta vendosë brenda kornizës së përgjegjësisë të kompetencave të tij; të ndërpresë çdo sulm kundër përfaqësive diplomatike të Shteteve të Bashkuara dhe të Bashkimit Europian në

Shqipëri; të ndërpresë çdo sulm ndaj parlamentit, të cilin nuk ka dyfek presidencial, që e cenon në legjitimitetin e vet, siç nuk ka dekret molotov që ia shkurton mandatin; të ndërpresë aktivitetin e tij të paligjshëm politik kundër qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me të cilën duhet të sillet siç e kërkon Kushtetuta dhe jo siç e urdhërojnë zërat e brendshëm të realitetit imagjinar, ku është transferuar së fundi. Do të ishte mirë të ndalonte edhe përgojimin e figurave heroike të historisë së këtij vendi, sepse paralelizmat mes tyre dhe figurës së tij keqinformojnë brezin e ri dhe simulojnë agresivitetin e injorancës ndaj shoqërisë dhe shtetit ligjor. Sidoqoftë, kjo mbetet një vërejtje miqësore.

I uroj punë të mbarë dhe të frytshme Komisionit Hetimor Parlamentar, si dhe uroj që, në emër të kësaj republike parlamentare, çdo deputet ta votojë ngritjen e këtij komisioni për të mos zhytur veten dhe këtë parlament në batakun ku kërkon ta zhysë Ilir Meta me imagjinatën e tij.

Ju falënderoj të gjithëve për vëmendjen!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Kryeministër!

Fjalën e ka zoti Arben Elezi. Të përgatitet Nimet Musaj.

Arben Elezi – I nderuar zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur miq dhe qytetarë,

Kur po vija drejt foltores, po mendoja nëse jam duke bërë gjënë e duhur apo të gabuar që po flas. Disa miq më kanë thënë se shumë shqiptarë, me të drejtë, mendojnë dhe thonë se ky Kuvend është katandisur në një Kuvend socialist. Kështu siç duket panorama, kushdo që na akuzon dhe na qorton ne deputetët e djathtë se jemi gabimisht në një Kuvend krejt socialist, duket sikur ka të drejtë, por u them “jo” atyre që mendojnë kështu. “Jo” ju them edhe juve, socialistëve që mund të shpresoni kështu. Ne, deputetët e djathtë, nuk jemi aspak gabimisht këtu, por jemi sepse dikush braktisi detyrën. Jemi këtu për t'u thënë të vërtetën në sy shqiptarëve, për t'u ballafaquar dhe për t'u thënë të vërtetat që mendojmë dhe që duan të dinë të gjithë qytetarët. Ne e dimë se ju, socialistët, edhe kur jeni në Presidencë, edhe kur jeni në qeveri, abuzoni me detyrën. Për ne nuk është aspak surprizë dhe çudi që Presidenti socialist, Ilir Meta, i quan dekretet “porosi me bllok në dorë”.

Nga ana tjetër, edhe ju socialistët në qeveri e vendosni si kandar farmacie Ulsiun e përgjimeve të Dibrës dhe doni që edhe reformën zgjedhore ta bëni me tërmetin Damian Gjikhuri. Ne nuk mund t'ju lejojmë të zaptoni, pa ju hyrë gjemb në këmbë, me planin tuaj diabolik të akaparimit dhe çifligarizimit socialist të Shqipërisë, të gjitha pushtetet dhe institucionet në vendin tonë. Ne jemi këtu për të votuar kundër çdo socialisti që abuzon me detyrën, kundër socialistit Ilir Meta, kundër socialistit Edi Rama, por edhe kundër socialistëve të tjerë problematikë, siç janë Ulsi dhe Damiani. Shqiptarët nuk ju meritojnë më ju në krye të punëve të qeverisë. Shqiptarët nuk ju meritojnë as në krye të 61 bashkive që jua dhuroi opozita, e cila braktisi detyrën. Shqiptarët nuk ju meritojnë as si pushtues të Presidencës apo të institucioneve të tjera.

Ju, nga natyra, bëni dëme të mëdha. Gjatë 50 vjetëve, kur ishit Parti Komuniste dhe Parti e Punës, keni bërë dëme dhe krime të mëdha. Tashmë ka ardhur koha që shqiptarët të meritojnë më të mirat. Ju duhet të ikni bashkë me Presidentin.

Ne, deputetët e grupit demokrat, mbështesim reformën në drejtësi që po bëjnë SHBA dhe BE. Ne e mbështesim vendosmërisht orientimin euroantantik proamerikan dhe proeuropian të Shqipërisë dhe duam që vendi ynë, për herë të parë, të ketë një reformë të thellë, të drejtë dhe çliruese zgjedhore. Pa një reformë zgjedhore të vërtetë gjithçka do të jetë bosh.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Elezi!

Fjalën e ka Nimet Musaj. Të përgatitet deputeti Zef Shtjefni.

Nimet Musaj – I nderuar, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë, që ndiqni këtë seancë, e cila ka shumë të ngjarë që për shkak të specifikës së saj, të jetë nga më të ndjekurat.

Dua që në fillim të fjalës sime të shpreh bindjen vetjake, që kapërcimi i këtij momenti politik duhet dhe është prioritet i klasës sonë politike. Ky moment politik, që duket si një sëmundje e keqe në trupin e demokracisë shqiptare, nuk vjen pa një çmim, që rëndon mbi supet e brishta të shoqërisë sonë.

Të nderuar kolegë,

Për fat të mirë, siç ka një çmim, ka edhe shpëtim, edhe shërim. Kjo sëmundje nuk është e pashërueshme nëse në sjelljen e politikanëve të caktuar do të kultivojmë më shumë përgjegjshmëri, seriozitet, maturi dhe atdhedashuri për vendin tonë.

Kjo sëmundje nuk është e pashërueshme nëse klasa e sotme politike do të ketë më shumë politikanë, që brenda vetes së tyre të kenë më pak urrejtje, më pak uri të pafre për pushtetin, më pak destruktivizëm ndaj çdo gjëje, që nuk mund dhe nuk duhet të jetë e tyre, sepse as nuk u takon dhe as nuk e meritojnë. Por, mbi të gjitha, do të kishim një trup të shëruar të demokracisë në vend jo nëse zgjedhjet e datës 30 qershor do të zhvilloheshin me më shumë apo me më pak votues, siç thanë shumë opinionistë, por nëse ata që kanë drejtuar dhe drejtojnë partitë, të cilët sillen dhe përsillen në politikën shqiptare që nga viti 1991, do t'i kishin bërë partitë trupa tërësisht demokratikë, ku anëtarët komunikojnë, bashkëveprojnë dhe bashkëndajnë ide dhe përgjegjësi për forcat e tyre politike.

Demokracia jonë nuk ra në krizë më 30 qershor, as pak para 30 qershorit, kur opozita la mandatet dhe braktisi reformat e vendit. Në atë kohë ne gjetëm një emër për krizën që lindi. Çfarë emri kishte kjo krizë? Ata që dje ishin partia jonë, përpara të cilëve opinionistët mbyllën sytë dhe veshët, u bënë sot sistemi ynë.

Për të parë se në çfarë pike u katandis ky sistem, ju lutem, ktheni kokën 10 vjet pas për të parë se çfarë transformimi pësuan partitë politike shqiptare. Ne lejuam që të na zhvishen partitë politike, asetet tona, ndër më të mëdhatë publike, në drejtim të organizimit të resurseve njerëzore, por mbi të gjitha kultura demokratike, e cila lë shumë për të dëshiruar. Si pasojë e kësaj kulture të munguar, sot ne kemi drejtues partish që duan të sillen me sistemin siç u mësuan të sillen me partitë e tyre, plot me teka dhe kapriço.

Të nderuar kolegë,

Këtë toleruam ne 10 vjet më parë, që sot vjen e shfaqet në formë dhe trajtë tjetër, e cila është në dëm të drejtpërdrejtë të vendit.

Sot ne kemi individë të mbipushtetshëm, që drejtojnë parti të zhveshura nga demokracia dhe si të tilla ato janë të dobëta përpara individëve që duan të arrijnë gjithçka dhe, kur nuk ia dalin, duan të shkatërrojnë çdo gjë. Përpjekjet për të shkatërruar i bëjnë përmes partive, të cilat, duke

mos qenë demokratike, sjellin këto situata ku ndodhemi sot.

Ne si shoqëri kurdoherë, kujtdo, duhet t'ia bënim të qartë se tjetër është partia, dhe, mbi të gjitha, tjetër është Shqipëria jonë.

Të nderuar kolegë, jemi të gjithë këtu, pa përjashtim, për ta bërë të qartë e të dukshme, përmes votës tonë, pikërisht këtë bindje dhe këtë orientim drejt Shqipërisë europiane.

Çfarë ndodhi në krizën institucionale, ku pa kursim dhe pa maturi u ushqye i gjithë opinionioni publik shqiptar?

Një miku im, që vjen nga bota e futbollit, nga Patosi, ku unë kam luajtur dhe kam qenë kapiten skuadre, ma përshkroi mrekullisht me fjalë të thjeshta situatën politike ku ndodhemi sot dhe i premtova se do ta them këtu në Kuvend përpara jush, të nderuar kolegë.

Dy skuadra futbollit, sipas kalendarit të miratuar nga federata, do të ndesheshin në finale. Data erdhi, biletat u shitën, tifozët kishin zënë vendet e tyre dhe njëra skuadër doli në nxehje e gatshme për ndeshje. Aty mësoi se skuadra tjetër nuk ishte paraqitur, sepse kishte mungesa dhe pretendime. Skuadra e paraqitur në fushë, duke i konsideruar absurditet pretendimet e skuadrës tjetër, priti daljen e arbitrave. Arbitrat, pasi u njohën me situatën, shënuan fitoren e skuadrës së paraqitur.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne këtu vijmë në pikën ku është përgjegjësi totale e këtij Kuvendi, i cili duhet të ngrejë zërin dhe të theksojë me forcë se ushtrimi i sovranitetit nga ana e popullit nuk mund të ndalet përpara asgjëje dhe sjelljet arbitrarë me pushtetin janë të patolerueshme.

Prandaj bëj thirrje që bateritë e energjive parlamentare të ruajnë fokusin e tyre kryesor edhe në reformat e vendit si:

1) Duam rezultate konkrete nga reforma në drejtësi. Këto i duam ne, por i duan edhe miqtë tanë ndërkombëtarë.

2) Shqiptarëve u duhet një drejtësi funksionale, pra të krijohet sa më parë Gjykata Kushtetuese dhe ajo e Lartë. Këto i duam ne, por edhe miqtë tanë ndërkombëtarë.

3) Duhet të ruajmë fokusin në ecurinë ekonomike e vendit, sepse raportohet një rënie me 1% të rritjes ekonomike. Pra, kërkohet reflektim dhe ndryshim sa më i shpejtë.

Ekonomia në kohëra të tilla krize politike mund të shndërrohet në një minë me sahat.

4) SPAK-u, të nderuar kolegë, duhet të krijohet sa më parë, në mënyrë që lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe lidhjes me to të bëhet më efektive dhe më konkrete.

5) Më e rëndësishmja, na duhet një sistem i ri zgjedhor, i cili demokratizon partitë dhe shfryn liderët e tyre. Pra, një sistem të ri që ta duan shqiptarët, sepse ata duhet të kenë besim në sistemin e tyre zgjedhor.

Ne mirëpresim çdo angazhim brenda dhe jashtë parlamentit, si nga shoqëria civile dhe nga grupet e interesit, patjetër edhe nga të gjitha partitë opozitare, në mënyrë që të bëhemi bashkë dhe të ndryshojmë sistemin zgjedhor. Përndryshe, kriza të ngjashme me të sotmet do t'i rikojmë sërish nesër, pasnesër, në muajt dhe vitet në vazhdim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju bëj thirrje se për të kapërcyer këtë krizë duhet të punohet në shumë drejtime.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Musaj!

Fjala për Zef Shtjefnin. Të përgatitet Suzana Topi.

Zef Shtjefni – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë shqiptarë, që jeni duke ndjekur punimet e këtij parlamenti.

Sot jemi mbledhur për të ngritur komisionin hetimor për Presidentin e Republikës, i cili ka shkelur Kushtetutën dhe ka abuzuar me detyrën e lartë, duke e përdorur tërësisht atë në shërbim të tij me zhdekretimin që i bëri datës së zgjedhjeve, duke i bërë një shërbim të keq vendit. Data e zgjedhjeve është vendosur me konsensus politik dhe nuk mund të zhdekretohet pa miratimin e të gjitha palëve politike, sidomos të atyre që janë regjistruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të marrë pjesë në zgjedhje.

Komisioni hetimor ka për detyrë të zbardhë të gjitha shkeljet e rënda ligjore që ka bërë Presidenti, të na raportojë në parlament dhe më pas me votë të bëhet shkarkimi i tij.

Zonja dhe zotërinj deputetë, Presidenti i Republikës nuk e njeh këtë parlament, e ka thënë edhe vetë, sidomos ne deputetët që morëm mandatet. Republika e Shqipërisë është republikë parlamentare dhe duket se edhe për shumë kohë

do të jetë e tillë. Askush nuk mund të dalë mbi parlamentin. Ai që përpiqet të dalë, do të ketë një fat si ky i kryetarit të shtetit, që e përdor detyrën për interesat e tij shumë të ngushta.

Zonja dhe zotërinj, gjatë këtyre 30 vjetëve në politikë unë kam dashur 3 liderë politikë: i pari ka qenë Azem Hajdari, i dyti ka qenë Sali Berisha dhe i treti ka qenë Lulzim Basha. Me zotin Basha u njohëm në “Çadrën e lirisë”, ku qëndruam 100 ditë. Pas marrëveshjes që bëri me zotin Rama dhe përfundimit të zgjedhjeve të vitit 2017, nuk u takuam më. Pas 2 vjetësh, kur bëri koalicion me LSI-në, për ne partitë e djathta nuk kishte më vend. Ne bëmë zgjedhjen e duhur, morëm mandatet dhe i shërbyem vendit; morëm pjesë në zgjedhje, si detyrim kushtetues dhe ligjor. Dhe bëra mirë, pasi në demokraci pushteti fitohet me votë dhe me beteja parimore këtu në parlament. Kështu donin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian, pasi vendi ishte në prag të procesit integruar dhe duhej angazhimi i të gjitha palëve. Marrëveshjet politike treguan se ky vend nuk mund të drejtohet duke i bërë qoka njëri-tjetrit një herë në dy vjet. Tani ka ardhur fundi dhe nuk ka më marrëveshje në kurriz të shqiptarëve, ka vetëm zbatim të ligjit dhe zgjedhje sipas ligjit dhe Kushtetutës.

Presidenti i vendit, përveç të tjerave, po përpiqet të hedhë në erë, edhe reformën në drejtësi, duke thënë se këtë reformë po e bën Soros-i. Të gjithë e dimë mirë se çfarë sistemi drejtësie kemi pasur?! Një sistem të kalbur nga krimi dhe korrupsioni, një sistem që prodhoi milionerë dhe miliarderë. Shikoni se çfarë heqin qytetarët për pronat e tyre, dhe nuk janë pak, por janë me mijëra që enden sot dhe gjithë ditën nëpër gjykata. Si mund të thuhet që reforma në drejtësi është e kapur, kur drejtohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Bashkimi Europian?!

Zonja dhe zotërinj, Soros-i në Shqipëri ka mbi 25 vjet dhe me të kanë punuar të majtë e të djathtë. Meqenëse qenka rrezik i madh për Shqipërinë, atëherë ta largojnë nga Shqipëria! Organet ligjzbatuese ta shpallin *nongrata*, po patën fakte konkrete, në të kundërt, mos e ushqeni më këtë popull, duke e mashtruar me gënjeshtër. Pra, sa herë që kemi probleme të brendshme këtu, i shpallim armiq të jashtëm, se ata qenkan e keqja e këtij vendi!

Një sulm i paprecedent u është drejtuar Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian, se këta kanë përkrahur qeverinë, thonë ata. Unë nuk besoj kurrë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian punojnë me qeverinë dhe opozitën. Në rastin konkret opozita i la institucionet dhe nuk mori pjesë në zgjedhje, por procesi dhe reforma në drejtësi duhet të vazhdojë.

Unë nuk kam menduar kurrë se Edi Rama dhe Partia Socialiste janë armiq të tanë. Ata janë kundërshtarët tanë politikë, por për interesat e Shqipërisë, për të përmbushur reformën në drejtësi dhe reformën zgjedhore do të bashkëpunojnë me ta, sepse nuk ka rrugë tjetër për Shqipërinë dhe shqiptarët që të integrohen me dinjitet në familjen e madhe europiane, së cilës i përkasim.

Unë kurrë nuk kam pasur asnjë lidhje me asnjë qeveri socialiste në këto vite. Kjo qeveri, që është sot në pushtet, më ka shkarkuar dy herë nga detyra, por jam sot këtu duke vazhduar betejën tonë si opozitarë dhe, me krijimin e Grupit Parlamentar të Partive të Djathta, që drejtohet nga kryetari i Partisë së Ballit Kombëtar, zoti Adriatik Alimadhi, do ta vazhdojmë betejën tonë.

Presidenti i Republikës po nxitohet edhe këto ditë, duke anatemuar reformën në drejtësi, pasi konsensusi mes PD-së dhe PS-së u prish te miratimi i ligjeve të vetingut. Reforma duhet të ecte përpara dhe ka dhënë rezultatet e saj, pasi shumë gjyqtarë dhe prokurorë janë larguar për shkelje të ligjit dhe për korrupsion me pasuritë e tyre.

Komisioni i vetingut nuk duhet të marrë kurrë urdhra politikë. As edhe një njeri i vetëm nuk duhet të rrijë në sistemin e drejtësisë me urdhra politikë, sepse edhe në qoftë se qoftë edhe për një gjyqtar apo prokuror janë faktuar shkelje, komisioni i vetingut do të mbajë përgjegjësi të rënda.

Ky parlament, që nuk na e njeh ky President, ka bërë edhe punë shumë të mira. Kemi miratuar shumë ligje për përmbylljen e paketës ligjore të reformës në drejtësi; do të përmbyllet reforma zgjedhore, si e vetmja zgjidhje që në këtë vend të bëhen një herë të vetme zgjedhje të lira e të ndershme, pasi jemi shumë kryetarë partish këtu dhe shumë të tjerë

janë jashtë, që presin nga ne përfundimin me sukses të reformës zgjedhore.

Dy vjet më parë kishin vendosur që t'i shkrinin partitë e vogla, por nuk ia arritën qëllimit. Ne jemi këtu për ta ndryshuar këtë sistem zgjedhor të kalbur. Kur të ketë votim biometrik dhe numërim elektronik, atëherë do t'i shikoni ju si do të dalin partitë e mëdha, që janë mësuar gjithë jetën duke marrë votat tona.

Në përfundim të fjalës sime, i bëj thirrje politikës 30-vjeçare të kuptojë një gjë: populli është lodhur duke ju dëgjuar; në këtë vend do të zbatohet vetëm ligji. Kushdo që do të mendojë se reforma në drejtësi do të dështojë, e ka gabim. Ka mbetur vetëm pak nga implementimi i reformës në drejtësi. Peshqit e mëdhenj të politikës, që e mbajnë peng këtë vend majtas dhe djathtas, do të përgjigjen një ditë para ligjit. Koha po vjen dhe shqiptarët po e presin me padurim.

Për shkelje të rënda kushtetuese, Presidenti duhet të shkarkohet dhe vendi i tij t'i jepet opozitës parlamentare, që ka dhënë një kontribut të madh për vendin. Grupi Parlamentar i Partive të Djathta do të japë një kontribut real për të gjitha shtresat e shoqërisë, duke sjellë për të miratuar në këtë parlament projektligje në dobi të qytetarëve shqiptarë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Shtjefni! Fjalën e ka zonja Suzana Topi.

Të përgatitet zoti Lifter Maliqi.

Suzana Topi – I nderuar zoti Kryetar i seancës,

Të nderuar deputetë,

Situata në Shqipëri është tronditëse. Kemi një qeveri që ka dalë nga vota të vjedhura dhe të blera nëpërmjet bandave, trafikantëve të drogës dhe kupolës së lartë shtetërore.

Kemi një qeveri, që ka kapur të gjitha pushtetet, si ekonominë, drejtësinë, parlamentin, medien dhe tani kërkon të instalojë totalisht sistemin monist në Shqipëri, duke bërë votime, por jo zgjedhje, më 30 qershor pa opozitën.

Vendi është në një krizë të thellë institucionale. Sipas modelit të qeverisjes së Edi Ramës, vendi nuk ka nevojë as për Gjykatë Kushtetuese, as për Gjykatë të Lartë, as për Prokuror të Përgjithshëm dhe as për President të Republikës. Ligji vepron vetëm për njerëzit e varfër, që burgosen se nuk paguajnë faturat

elektrike apo për një shtesë ballkoni pa leje; burgosen dhe helmohen me gaz fëmijët në Unazën e Madhe, në Bregun e Lumit se protestojnë për shtëpitë e tyre, të cilat kërkonin t'ua prishni pa proces ligjor dhe pa i shpërblyer për djersën dhe sakrificën e tyre; burgosen qytetarë, që protestojnë me duar në xhepa, për largimin e kësaj qeverie ilegjitime, si: kryetari i Partisë Demokratike të Përrenjasit, zoti Arjan Karriqi, apo kryetari i Partisë Demokratike të Librazhdit, zoti Bujar Vreto, si dhe shumë të tjerë me urdhra nga deputetë dhe qeveritarë, të cilët lejohen prapë me urdhër të tyre.

Ky ligj nuk vepron për kupolën e lartë shtetërore, duke filluar nga Kryeministri, ish-ministra, deputetë, drejtorë drejtorish, komisarë, drejtorë policie, drejtorë shkollash, mësues, rrjete kriminale dhe oligarkë dhe për të gjithë ata me të cilët ju bashkëpunoni. Pra, një armatë e tërë shtetërore e lidhur me krimin dhe oligarkët ka shkatërruar dhe masakruar procesin zgjedhor të vitit 2017. Të gjithë të kapur me pazare të fëlliqura për shitblerje votash, mbledhje të kartave të identitetit, ndalim të votuesve të opozitës për të shkuar në zgjedhje dhe presion ndaj administratës për vendet e punës. Bashkëpunimi i qeverisë me krimin e organizuar dhe oligarkët ka deformuar vullnetin e lirë të popullit në këto zgjedhje.

Faktet e dosjeve hetimore 339 dhe 184, me të cilat janë njohur jo vetëm shqiptarët, por edhe kancelaritë e huaja nëpërmjet gazetës gjermane "Bild" dhe medie shqiptare, nuk janë hetuar nga prokuroria, e cila i bëri hetimet, por që i mban në sirtar prej tre vjetësh vetëm për t'i shërbyer pushtetit tuaj. Të gjithë shkaktarët e prishjes së zgjedhjeve duhet të vihen në dispozicion të hetimit për zbardhjen e krimeve zgjedhore. Shkaqet reale të kësaj krize të thellë janë shumë, prandaj shqiptarët po ikin nga Shqipëria, sepse nuk ka punë dhe nuk kanë asnjë shpresë të qëndrojnë në vendin e tyre, ekonomia është monopolizuar dhe bizneset po tkurren për shkak të taksave; shërbimet spitalore janë të kushtueshme; tarifat studentore janë të larta; pensionet, kempet, asistencat janë shumë të ulëta...

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Topi!

Fjala për zotin Lifter Maliqi. Të përgatitet Besnik Troplini.

Lifter Maliqi - Të nderuar shqiptarë,

Siç po e shikoni, sot kjo është një farsë dhe një gjyq politik. Ju dëgjuat para pak minutash Kryeministrin e “Rilindjes” dhe jo të socialistëve, i cili sot, pas farsës elektorale dhe zgjedhjeve të 30 qershorit, është Kryeministri i pakicës, ku vetë patë se si lotët e tij tregonin disfatën dhe humbjen që e pret nga zgjedhja në zgjedhje për shkak të krimit të organizuar, korrupsionit, papunësisë dhe varfërisë që ka pllakosur vendin.

Sot Kryeministri foli me ëndrrën e tij prej diktatori dhe i bëri gjyqin politik Presidentit të Republikës. Nuk ka më skandal dhe më turp kur ju të gjithë të maxhorancës, së bashku me këta mbrapa i bëni gjyqin politik një njeriu që ju solli në pushtet në vitin 2013, duke filluar që nga Kryeministri, i cili i lutej me ngjala apo me takime natën me Koçon, të cilin e hodhi në rrugë, ashtu siç hodhi edhe shumë të tjerë, ku disa prej tyre, deputetë dhe ish-deputetë, u arrestuan.

Të gjithë shqiptarët duhet të kuptojnë një gjë thelbësore: nuk ka gjë më të poshtër dhe më të keqe se mosmirënjohja. Zoti Meta, i cili ka qenë Kryeministri i tyre, ka qenë kryetar i FRESH-it dhe student i Dhjetorit; në vitin 2007 i dha bashkinë dhe ky që ishte kryetar bashkie i rrinte mbrapa kur ishte Kryeministër. Pra, këta ia kanë frikën dhe e dinë shumë mirë se opozita e bashkuar këta i nxjerr në pakicë, në minorancë, dhe e shikojnë në ëndërr atë dhe Partinë Demokratike për shkak të bashkimit të madh që do të ndodhë.

Shqiptarët tashmë janë 6 vjet mbrapa, sepse kanë papunësi, varfëri, lidhje me krimin, korrupsionin, kontrabandën dhe emërime nepotike, që i bën krimi i organizuar. Shikoni se kush do ta drejtojë komisionin hetimor, Ulsiu, i cili është nën hetim nga përgjimet që janë publikuar në gazetën “Bild”, e nderoi me Dibrën.

Deputetët e opozitës së re thonë që nuk do të jenë dakord me vendimet e Partisë Socialiste, por këtë do ta shikojmë sot kur të votojnë, sepse i pashë atë ditë kur të gjithë thanë se do të abstenojnë dhe pas 40 minutash Taulanti me të tjerë i kapi grupe-grupe dhe votuan rezolutën për shkarkimin e Presidentit të Republikës. Ky është turp!

Unë u bëj thirrje të gjithë shqiptarëve dhe opozitës të mos ngrihen në protesta 1 orë apo 2 orë, por me revoltë demokratike popullore deri në rrëzimin përfundimtar të kësaj qeverie të

lidhur me krimin. Koha është sot, sepse nesër do të jetë vonë. Këta nuk e kuptojnë gabimin, humbjen e quajnë si fitore dhe dështimin e quajnë triumf. Është turp kush po na drejton dhe kush po e udhëheq këtë popull, me krim, banda, korrupsion e me radhë.

Gramoz Ruçi- Faleminderit!

Urdhëroni, çfarë kishit për procedurë?

Besnik Troplini– Meqenëse minutazhi është i shkurtër dhe nuk e përmbledhim dot atë që kemi në mendje, meqenëse jemi të dy të një partie, a ka mundësi që 3 minutëshin tim t’ia kaloj zotit Roshi dhe të flasë vetëm njëri e të ketë kuptim ajo që do të thotë, sepse përndryshe do të rrimë me fjalë spontane dhe të cunguara e nuk do të ketë asnjë kuptim fjala e mbajtur?

Gramoz Ruçi –Bëtë mirë që u tërhoqët, sepse keni dy minuta më shumë nga koha që ju është caktuar, kështu që nuk ka problem.

Fjalën e ka zonja Elisa Spiropali. Të përgatitet Halit Valteri.

Elisa Spiropali – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Ilir Meta nuk ka shkelur rëndë vetëm Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, siç e ka renditur qartë rezoluta e Kuvendit dhe raporti i Komisionit të Ligjeve, por, më zi akoma, ka shkelur brutalisht mbi Republikën tonë parlamentare, si dhe vijon e marshon komikisht mbi kodet e komunikimit publik, duke cenuar rëndë bashkëjetesën politike. 6 muaj përpjekje antikombëtare për të destabilizuar Shqipërinë, duke shkatërruar zgjedhjet e 30 qershorit. Molotovët dhe flakadanët vërtet i mbante në dorë opozita e rrugës, por urat e flakës i mbante ndezur Ilir Meta nga zyra e Presidentit të Republikës. Për muaj të tërë Shqipëria përjetoj kërcënimet e urrejtjes politike, të llumit mediatik dhe të kaosit shoqëror. Në asnjë moment Presidenti i Republikës, si kreu i shtetit nuk doli mbi këtë turp kombëtar. Ai ushqehu përditë me lugën e zbrazur të dekretit nul shpresat e çartura të opozitës së rrugës për ta kthyer 30 qershorin në ditën e përplasjes finale, ku shteti shqiptar do të merrte goditje fatale nga e cila, nuk e di, a do ta merrte veten për shumë dekada në kalendarin europian. Shqipëria mund të kthehej në makthin e shqiptarëve dhe në ëndrrat më të bukura të armiqve tanë si një vend që nuk bën dot shtet, që nuk organizon dot zgjedhje dhe që nuk bashkëjeton dot paqësisht.

Duke nxitur instinktet më të ulëta të luftës pa fre për pushtet, Presidenti u kthye në simbolin kombëtar të paligjshmërisë, pandëshkueshmërisë, harbutërisë, dhunës, padrejtësisë dhe kërcënimit, duke cenuar rëndë bashkëjetesën demokratike dhe imazhin e Shqipërisë.

Presidenti nuk dekretoi dhe zhdekretoi thjesht një datë zgjedhjesh, duke shpikur një praktikë të paprovuar dhe të padëgjuar në historinë botërore. Ilir Meta nga zyra e Presidentit planifikoi kthimin pas të orës së Shqipërisë. Kumtet e tij ishin të qarta, kiameti u bëftë, Shqipëria kurrë mos u bëftë! Atentati ndaj të ardhmes europiane të Shqipërisë, i planifikuar në bashkëpunim me Sali Berishën, me zbatues Lulzim Bashën dhe Monika Kryemadhin ishte gjakftohtë dhe me paramendim. Ky atentat dështoi jo vetëm prej vendosmërisë së kësaj shumice dhe këtij parlamenti për të mos bërë pazar me të ardhmen, por edhe prej mbështetjes pa asnjë cedim të partnerëve tanë: SHBA-ve dhe BE-së.

Në këtë udhëkryq, këta miq historikë u gjendën më fort se kurrë në krahë të shqiptarëve, të demokracisë dhe të së drejtës, duke na dëshmuar për të disatën herë me provë se për ne dielli lind nga perëndon.

Në kërkesën për shkarkimin e Ilir Metës nga posti i Presidentit ne kemi argumentuar se ai ka cenuar rëndë parimin e sovranitetit të popullit; ka shkelur Kushtetutën dhe ka marrë njëkohësisht tagra të sovranit dhe të Kuvendit; është sjellë arbitrarisht me pushtetin përkundër natyrës së republikës parlamentare; ka anuluar arbitrarisht datën e zgjedhjeve; ka cenuar parimin e periodicitetit të zgjedhjeve; ka cenuar parimin e ushtrimit të pushtetit në një shtet nga një qeverisje e dalë nga zgjedhje të lira; ka cenuar parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë; ka nxjerrë një akt në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin; ka cenuar parimin e të drejtës së qytetarit si sovran për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Por, mbi të gjitha, Ilir Meta po cenon përditë besimin e qytetarëve tek institucioni i kreut të shtetit, po përgojon partnerët tanë, po cenon rëndë unitetin e popullit dhe po tall një popull të tërë.

Ta ngremë këtë komision sa më parë, jo për të shpëtuar Ilir Metën nga vuajtjet e kafazit të

Presidencës që, t'i japim mundësinë të kthehet sa më shpejt te livadhi i LSI-së, por për të shpëtuar institucionin e Presidentit të Republikës dhe vetë republikën tonë nga turpërimi i mëtejshëm.

Në fakt, kam edhe diçka personale. Sa për zagarët dhe qenushet që ka hedhur në sulm partia e tij kur reagoi për marrosjen presidenciale, kam si përgjigje vetëm vargjet e Poradecit: "Shpirt katranë që më qortojnë, janë qenë që s'më kafshojnë!".

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Faleminderit, zonja Spiropali!

Fjalën e ka deputeti Halit Valteri. Të përgatitet Andi Përmeti.

Halit Valteri - Si anëtar i Komisionit hetimor për shkeljet kushtetuese të Presidentit, vetëm ndriçimi dhe vezullimi i pasurisë së tij më bëjnë më të vetëdijshëm që shoku Ilir Meta e meriton një hetim, pse jo edhe shkarkimin. Nuk e kam problem të deklaroj se Ilir Meta nuk është Presidenti im, sepse Ilir Meta është Presidenti i partisë së tij, i asaj pale që ia ka lënë amanet Monikës dhe mbron interesat vetëm të asaj pale që i lexon pas veshit çdo natë. Prandaj do ta kishim më të lehtë dhe nuk do të kishim arritur deri në këtë ditë nëse, përveç komisioneve hetimore për shkelje kushtetuese, do të ndërmermim edhe disa komisione hetimore pasurore për politikanët.

Dua t'i drejtoj një pyetje të gjithë klasës politike në Shqipëri: a ndiheni ndonjëherë në faj apo nën presion për mënyrën tuaj të jetesës, të luksit të tepruar që bëni, duke filluar nga makinat super të shtrenjta, shtëpitë e pushimeve, vilat dhe sarajet, veshjet dhe orenditë milionëshe, ndërkohë që shqiptarët janë të detyruar prej skamjes dhe pamundësisë të marrin rrugët e botës, të largohen çdo ditë nga vendi, të cilit ata i dhanë gjithçka dhe nuk i morën mbrapsht asgjë? A keni ndonjë përgjegjësi për këta njerëz? Pa dashur të bëj hokatarin me ju, këtë pyetje pa dyshim do t'ia drejtonte edhe gazetarja e "Zërit të Amerikës" Ardita Dunellari, gjithsecilit prej jush, nëse gjithsecili prej jush do të kishte pasur fatin të ulej në karrigen e studios së saj, siç bëri Presidenti para pak kohësh. Si do t'i përgjigjesht ju: "Jo, aspak, se këto janë spekulime. Nuk është e vërtetë. Ne nuk jetojmë në luks!". Por nuk e dini se çmimi i një ore, i një këmishe, i një çante tuajës do të shuante urinë e një familjeje

shqiptare të paktën për disa muaj, të mos them edhe për një vit. Të jeni të sigurt se të njëjtën pyetje do t'ju drejtonte sot i gjithë populli shqiptar, i velur nga shfaqet tuaja të luksit, kapardisjet me pasuritë e vëna me “djersën e ballit”, pa dyshim, por duke rënduar xhepat e gjithsecilit prej tyre. Me “djersën e ballit” e çuat vendin në zgrip, sepse kurrë nuk punuat për qytetarët e vendit tim, që, megjithëse i kishte dhe i ka të gjitha të drejtat të jetojë si popull i qytetëruar, nuk arriti për 100 vjet të jetë i tillë, sepse juve nuk ju intereson një gjë e tillë, por e doni popullin të varfër deri në skamje, që të keni mundësi t'i blini votën, ta kërcënoni me vendet e punës apo të bëni pazare me bukën e gojës dhe me të gjitha gjërat e këqija me të cilat i kërcënoni këta fëmijë apo të rinj, të cilët largohen çdo ditë, duke ua blerë heshtjen, teksa ju ngiheni çdo ditë dhe ktheheni në pasanikë e në bejlerë, edhe pse të padrekë ju gjeti dreka, milionerë ju zuri darka.

Psenë e dimë të gjithë, por psenë nuk duhet ta harrojmë, ngaqë ju jeni shkaktarët kryesorë dhe arkitektët e kësaj poshtërsie, zallamahie, pasigurie, padrejtësie, papërfaqësie, si dhe të shumë “pa”-ve të tjera, që nuk mbarojnë kurrë. Por ju nuk dorëzoheni. Çdo pabesi, e bërë në kurriz të shqiptarëve, ndez shpresën tuaj me ëndrra të fikura për t'i mashtruar ata sërish me gënjeshtër për etjen tuaj në lidhje me reformën në drejtësi: SPAK-un, BKH-në, se, gjoja, mezi po e prisni të vijë ajo ditë.

E dëgjojmë shpesh Kryeministrin të thotë se shqiptarët nuk i gënjeni dot, se shqiptarët janë të zgjuar. Nuk besoj se ka njeri në këtë sallë apo jashtë kësaj salle që mendon se shqiptarët s'janë të zgjuar, por, ama, nuk e pranon dot as Kryeministri e as qeveria se tashmë shqiptarët janë bërë të paduruar, duke dëgjuar çdo ditë klounin e radhës, që sillet rrugëve me torbën e mashtimeve të mbushur plot. Sa herë ia lyp nevoja, tregon si barsolëtë gënjeshtërën e radhës, sa për të mbajtur frymën gjallë, aq edhe për të shuar etjen e tyre për drejtësi.

Shqiptarët janë të zgjuar, por për të mbrojtur xhepat e tyre dhe kafshatën e fëmijëve të tyre, jo për vilat dhe sarajet tuaja, vetëm ngaqë ju bëni deklarata se i doni shumë, ndonëse sot i keni katandisur edhe më të varfër, edhe më të pashpresë se çdo qytetar në shtet tjetër të Europës.

Shqiptarët janë të zgjuar, dhe po shikojnë shfaqjen e fundit të përpëlitiëve nga makthi dhe tmerri që i ka kapur të poshtrit e këtij vendi. Shqiptarët janë të zgjuar dhe po presin që të fillojë vetingu i politikanëve, që të nisin mortin e zotërinjve kriminelë. Ju jeni të dënuar, dhe do të vijë ora, kur xhelati i vetingut do t'ju presë litarin e gijotinës. Britma juaj nuk do t'ju shpëtojë dot.

Ndërsa unë do të jem këtu për t'ju parë në sy, në emër të gjithë shqiptarëve të zgjuar, të cilëve do t'ua përshpejtoj këtë kënaqësi. Është e sigurt, sipas të gjitha gjasave, se Presidenti do të pyetet i pari nga xhelati i vetingut që të japë përgjigje për të gjitha akuzat, që shqiptarët pyesin veten çdo ditë, sikurse u përgjigj me zë të mekur në studion e gazetares së “Zërit të Amerikës”, por edhe për të larë gjynahet e demokratëve, të cilëve u ka shkaktuar një kosto të jashtëzakonshme politike: një herë me skemën e Dushkut të madh të 2001, kur mbante postin e Kryeministrit, dhe i la demokratët të papërfaqësuar në parlament, me ato zgjedhje të pandershme që i pa I gjithë vendi; më pas duke i faturuar fajin në lidhje me ngjarjet e “21 janarit” për ca shënime te blloku i tij i kuq dhe i zi, por që arriti të shpëtojë me anë të marrëveshjes së aleancës së qelbësirave, me deklaratën e famshme të ngjalave, e bërë në fshehtësi te Gjiri i Lalzit.

Prandaj, sot më duket anormale mbajtja e Metës si bashkëpunëtor i afërt i Partisë Demokratike, i partisë që ai e bashkëdrejton me gruan e tij, ndërmjet gruas.

Fati i Ilir Metës është i shkruar me germa floriri, dhe neve s'na mbetet gjë tjetër veçse t'ia bëjmë më të lehtë rrugë e tij pa kthim drejt qelive të ftohta, pas këtyre ditëve të nxehta vere.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Valteri!

Fjala për Andi Përmetin. Të përgatitet Artur Roshi.

Andi Përmeti – Të nderuar kolegë,

Ilir Meta duket shumë i shqetësuar këto kohë dhe kjo duket nga mënyra si flet, nga ato çfarë flet, si dhe nga ato çfarë shkruan. Duket se Ilir Meta ka një hall të madh, një hall aq të madh, sa tejkalon çdo hall të mundshëm politik. Kjo duket në fytyrën e tij, në shprehjet e tij.

Presidenti i Shqipërisë ka një hall të madh, një hall shumë të madh, por unë sot nuk ndiej

keqardhje për të. Nuk ndiej keqardhje, kur mendoj se çfarë i ka bërë Ilir Meta këtij vendi për njëzet e ca vjet, vetëm e vetëm për interesat e tij, vetëm e vetëm për interesat e familjes së tij.

Sot unë ndiej keqardhje vetëm për opozitarët, për ata demokratë të thjeshtë, të cilët sot e kanë bërë Ilir Metën hero. Ilir Meta hero i demokratëve! Një absurd i cili për nga absurditeti edhe vetë Kamysë do t'i dukej absurd.

Ilir Meta hero i demokratëve! O Zot i madh!

Sot unë ndiej keqardhje për këta demokratë, të cilët kanë bërë hero të tyre Ilir Metën.

Dua t'u drejtohem miqve të mi, me të cilët jam rritur, por edhe mijëra opozitarëve që kam njohur ndër vite: a ju kujtohet çfarë i ka bërë elektoratit të djathtë Ilir Meta në vitet 2009 – 2013? A ju kujtohet se si pushtetin, që i dha PD-ja, e transferoi te ky mbrapa? Ishte ai që e solli në pushtet, dhe ishte po ai që e mbajti në pushtet. A ju kujtohet se si në vitet 2013-2017 LSI-ja e Ilir Metës hodhi në rrugë pa të drejtë me mijëra demokratë? A ju kujtohet kur Basha dhe ju të tërë e quanit kryetari i organizatës kriminale të blerjes së votave në Shqipëri?

A ju kujtohen të gjitha këto, miqtë e mi?

Sot ju e keni hero atë, dhe për këtë unë ndiej keqardhje. Tashmë ka ardhur dita që t'ju bëj një thirrje:

Të dashur opozitarë, mos u gënjeni më nga Ilir Meta dhe as nga pazari Basha-Rama. Ishte ai pazar i fëlliqur që ia shiti të gjithë pushtetin Edi Ramës më 2017-ën. Po, po, ia shiti. Mos u gënjeni! Ndërsa sot ia fali të 61 bashkitë në tavolinë, duke i lënë demokratët në mes të rrugëve dhe në mes të mëshirës së këtij pushteti kriminal, demokratë, të cilët nuk do të humbisnin kurrë në bashkitë e tyre, po të përballeshin. Basha ia fali!

Prandaj, sot ka ardhur koha t'i shporrim që të gjithë. Ka ardhur koha pikërisht sot, tani, që këtu, duke filluar me Ilir Metën, për të vazhduar më pas me dy pazarxhinjtë. Sepse jeni ju që vuani burgjeve, ndërkohë që ky është Kryeministër, ndërsa ai është në Holandë. Edhe kur s'është në Holandë, do të thotë dikush, është holandez ai dhe familja e tij. Prandaj, le të fillojmë t'i shporrim që sot një e nga një.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Përmeti!

Fjalën e ka Artur Roshi. Të përgatitet Erion Piciri.

Artur Roshi – Zoti kryetar, para se të filloj, dua që t'i jepni porosi IT-së se kam edhe tri minutat e zotit Troplini. Prandaj u tërhoq nga...

Gramoz Ruçi – Urdhëro!

Artur Roshi – Tri minutat e zotit Troplini, që u tërhoq nga...

Gramoz Ruçi – Jo, nuk lejohet të kalojnë...

Artur Roshi – Jemi të një partie. Kjo ka ndodhur edhe herë tjetër.

Gramoz Ruçi – Le të jeni në një parti! Nuk lejohet të kalojë koha nga një deputet tek tjetri. Kjo është e para.

E dyta, koha e zotit Troplini ishte mbi kohën që është përcaktuar për deputetët e pavarur.

Mund të vazhdoni. Keni në dispozicion vetëm tri minuta.

Artur Roshi – Dakord.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Balli Kombëtar Demokrat është pjesë e koalicionit opozitar, por nuk është kjo arsyeja që mendoj se ngritja e komisionit hetimor për Presidentin e Republikës është një ngutje, që nuk i përshtatet Kuvendit, si organ i një mendimi të epërm, që lidhet me të ardhmen e një demokracie stabile.

Nuk besoj se ka kuptim një komision në një moment të tillë, kur efekti i veprimit, ai i aktit të zhdekretimit të Presidentit të Republikës, nuk funksionoi.

Duhet të mësohemi me faktin që shteti ligjor nuk lëviz me emergjenca, me situata emocionale e fuqi pushteti, por në mënyrë konstante dhe parimore.

Kush shkel ligjin apo parimet, është në rrugën e gabuar dhe gabimi nuk kërkon afat për ta gjykuar. I rëndësishëm është gjykimi i sigurt, ndryshe nga deri më sot, mosgjykimi i sigurt.

Askush nga ne nuk është roja i shtetbërjes apo i ligjshmërisë. Është një sistem më vete ai i drejtësisë, që thjesht duhet ta lëmë të ngrihet dhe të funksionojë.

Çdo veprim me efekt mbi publikun duhet gjykuar për pasojat afatgjata që sjell.

A pati pasoja dekreti i Presidentit? Në periudhë afatshkurtër jo, sepse kriza ligjore e momentit, me presionin pozitiv të Perëndimit, u

tejkalua. Në afatgjatë? Sërish jo, sepse kjo eksperiencë do të na bëjë ta korrigjojmë.

Kushtetuta është besimi demokratik i qytetarëve, që integron të gjithë interesin e lirisë dhe të të drejtave të tyre si mjet kontrolli ndaj politikës.

Presidenti kishte bindjen se zhdekretimi do ta zgjidhte krizën. Bindja është shtysa më e fuqishme te njeriu. Te bindja e Presidentit besojnë një numër i konsiderueshëm njerëzish. Kjo do të thotë se Presidenti nuk e ka shkelur tërësisht besimin e qytetarëve të Republikës, pra nuk e ka cenuar në thelbin e vet Kushtetutën, edhe pse mund të kemi dyshime që ka shkelur procedurën e saj.

Kushtetuta e bën maturinë e politikës një çështje nevojë, jo një çështje dëshire, që vjen prej fuqisë dhe epërsisë së momentit.

Çfarë do të hetojë komisioni hetimor?! Nuk ka objekt hetimi, sepse zhdekretimi nisi si një bindje e Presidentit për të zgjidhur krizën.

Nëse do të kishim Gjykatë Kushtetuese, a do të vlente ngritja e këtij komisioni hetimor? Jo, sepse Gjykata Kushtetuese mund ta rrëzonte zhdekretimin, por Presidenti do të qëndronte sërish në detyrë.

A do të sjellë pasoja ngritja e komisionit hetimor? Po, sepse do të dëmtojë figurën e Presidentit dhe do të krijojë precedentë të tjerë për ngritje komisionesh hetimore, sa herë që një shumice do t'i duket se veprimet e tij janë në shkelje të Kushtetutës.

Do ta mbyll me një shprehje të Burkes, që e kam për zemër: "Maturia është kudo një virty, por në politikë është e para e virtyeve."

Faleminderit!

(Drejtimitin e seancës e merr zonja Vasilika Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Roshi!

Fjalën e ka deputeti Erion Piciri.

Ne bazë të Rregullores, nëse deputeti nuk është i pranishëm, konsiderohet që ka hequr dorë nga fjala e tij.

Fjalën e ka deputetja Elda Hoti. Keni tri minuta kohë.

Elda Hoti - Nuk dua të ndalem tek argumentet kushtetuese, që e bëjnë këtë seance të pavlefshme. Ato i gjykojnë konstitucionalistët dhe duhet t'i gjykojë Gjykata Kushtetues, nëse do t'ia dalë të jetë jopartiake.

Dua vetëm t'ju kujtoj që jeni maxhorancë dhe keni përgjegjësinë kryesore për situatën e konfliktit politik, të cilin po e thelloni.

Presidenti ju dha mundësinë të mos hynit në zgjedhjet moniste, ju krijoi hapësirën për dialog, duke dhënë një datë tjetër për të qetësuar gjakrat dhe për të gjetur rrugën e zgjidhjes, por ju e refuzuat dhe nxorët që aty një konflikt të ri.

Pasi eliminuat opozitën nga të gjitha institucionet, keni vendosur të hiqni shenjën e fundit të demokracisë në vend, Presidentin.

Ju nuk mund ta pranoni një institucion të rëndësishëm, që drejtohet nga një politikan i fortë, nëse nuk i shërben ambicies suaj.

Ju nuk reflektoni pas gabimeve, por nxitoni të bëni një gabim të ri, që të harroni të parin.

Tani jeni shndërruar në grupimin politik që po rrezikon demokracinë në vend dhe nuk ngurroni ta bëni këtë mu në tempullin e demokracisë, këtu, në Kuvendin e Shqipërisë.

Sot ju nisni rrugën e kapjes të shtetit 100%.

Kur pranova të merrja mandatin, në fakt, dyshova nëse po bëja atë që duhej. Mbështesja çdo tezë të LSI-së, përveç dorëzimit të mandateve. Sot jam e bindur që kam bërë atë që duhet.

Jam këtu për t'u rreshtuar në anën e duhur të historisë, për ta denoncuar dhe për t'i nxjerrë kartonin e kuq aventurës totalitare të një grupimi politik, që po merr peng të gjithë vendin.

Ju kurrë nuk do ta shkarkoni Presidentin. Aventurat diktatoriale janë të destinuara të dështojnë. Do të jem dëshmitare e dështimit tuaj të turpshëm për të rrëzuar rezistencën e fundit të demokracisë, me krenarinë që isha këtu për t'u rreshtuar në anën e duhur të historisë.

Votoni kundër shkarkimit të Presidentit! Vendosni flamurin para dhe tregohuni burra, si gjithnjë!

Unë kam një ëndërr: ta shoh Shqipërinë time të lulëzuar në çdo drejtim dhe një vend të begatë për të rritur fëmijët e mi.

Unë dhe çdo i ri në këtë vend kemi një ëndërr të madhe të përbashkët: të jetojmë të lumtur në Shqipërinë tonë demokratike.

Ju vetëm për një gjë e keni mbajtur fjalën (se zakonisht nuk e dini ç'domethënë të mbash fjalën), kur keni thënë: "Nuk keni parë gjë akoma".

Por dua t'ju them që, nëse do të provoni ta shkarkoni kryetarin e shtetit, atëherë nuk keni parë gjë akoma!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Hoti!

Fjalën e ka deputeti Kujtim Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zonja Nënkrjetare!

Pse duhet shkarkuar Ilir Meta?

Ilir Meta duhet shkarkuar, se ka përgjegjësi për thesarin e Kërrabës.

Ilir Meta ka përgjegjësi për grabitjen e mandateve në vitin 2001 me Dushkun e famshëm.

Ilir Meta ka përgjegjësi, sepse në datën 2 dhjetor të vitit 2001 ka pasur dijeni për një grup kriminal, që ka ardhur të vrasë Zef Bushatin në Shëngjin, Lezhë.

Ilir Meta duhet shkarkuar, sepse ka pasur ndikim në Nikël, deri sa erdhën në parlament deputetë të tjerë të opozitës. Ilir Meta duhet shkarkuar se në vitin 2017 mori pjesë në fushatën zgjedhore, Ilir Meta duhet shkarkuar, sepse ka ceduar me dy data zgjedhjesh dhe i ka çorientuar të gjithë votuesit shqiptarë. 85% e shqiptarëve nuk kanë ditur se çfarë të bëjnë, se çfarë thotë Presidenti dhe çfarë thotë gjeneral Gedafi. Gjeneral Gedafi nuk është këtu dhe do të ishte mirë që të ishte në këtë seancë shumë serioze (e kam fjalën për Kryeministrin). Unë nuk do të doja kurrë që fatin e gjeneral Gedafit të Libisë ta kishte Kryeministri ynë; nuk e kam dashur dhe nuk e dua kurrë, por ne duhet të marrim me mend dhe të shohim se çfarë është bërë në datën 30. Ne konservatorët e njohëm datën e Presidentit, por jo Presidentin, sepse ju duhej ta kishit shkarkuar atë pa ardhur akoma te kjo situatë, se keni shkuar në Shkodër dhe jeni të maturuar akoma nga Tadiçët e Serbisë, ashtu si diktatori Hoxha në vitin 1944. Prandaj, ju duhet të thoni: “Na falni ju shqiptarë që zgjodhëm Ilir Metën!”.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Fjalën e ka Taulant Balla.

Taulant Balla – Të nderuar kolegë deputetë, nuk ka shumë për të diskutuar në këtë seancë, por si kryetar i grupit të shumicës, njëkohësisht një prej 55 firmëtarëve të kësaj kërkesë, dua të them se në 28 vjet të këtij Kuvendi është hera e parë që ngrihet një komision hetimor për të hetuar ligshmërinë e

veprimeve të kryetarit të shtetit, i cili shkoi në kushtet e shkëljes së rëndë të Kushtetutës. Do të doja t'u kërkoja të gjithë deputetëve, në një praktikë të konsoliduar tashmë të funksionimit të komisioneve hetimore, ta ngremë këtë komision hetimor me konsensus të plotë dhe t'i kërkojmë komisionit hetimor të përmbushë detyrën e vet brenda tre muajve me një transparencë të plotë për publikun, me qëllim që përfundimet e këtij komisioni të përmbushin pritshmëritë e kërkuarve, në vlerësimin tonë. Por, sigurisht, i takon komisionit hetimor ta qartësojë të gjithë këtë situatë, ku, të gjithë e pranojmë se jemi në shkëlje të rëndë të Kushtetutës.

Në këtë kuptim, dua t'u kërkoj edhe një herë të gjithëve të votojmë pro ngritjes së këtij komisioni hetimor!

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zoti Ruçi.)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Balla!

A jeni gati për votim?

Të hiqen kartat e deputetëve që nuk janë në sallë!

Hapet votimi për prezencën.

Zonja Topi nuk është?

Atëherë t'i hiqet karta!

Mbyllet votimi.

111 deputetë prezentë.

Fillojmë me votimin e projektvendimit “Për miratimin e raportit të propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta”. Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, projektvendimi kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Procedura e votimit është votim i hapur me elektronikë.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 102 vota pro, 7 vota kundër, 2 abstenime.

Miratohet raporti dhe propozimi i Komisionit të Ligjeve. Sipas pikës 3 të nenit 112 të Rregullores në rast se Kuvendi nëpërmjet votimit të raportit pranon propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, atëherë brenda 2 ditëve ngrihet komisioni hetimor për këtë çështje.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 8 KORRIK 2019

Projektvendimin për ngritjen e komisionit hetimor e keni të gjithë në tavolinat e punës. Përbërja do të jetë me 9 anëtarë, 5 nga maxhoranca dhe 4 nga opozita. Kryetarët e grupeve parlamentare kanë propozuar këta emra: Ulsi Manja, kryetar, Alban Zeneli, zëvendëskryetar, Vasilika Hysi, anëtare, Klotilda Bushka, anëtare, Bashkim Fino, anëtar, Alket Hyseni, anëtar, Adriatik Alimadhi, anëtar, Halit Valteri, anëtar, Krenar Rryçi, anëtar.

Anëtarë, zëvendësues do të jenë: Adnor Shameti dhe Spartak Braho nga PS-ja, Arlind Çaçani nga Grupi Demokrat dhe Zef Shtjefni nga Grupi i Partive të Djathta.

Kalojmë në procesin e votimit të projektvendimit për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar, i cili, në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores, kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Votimi është i hapur me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi

Janë 101 vota pro, 6 vota kundër, 3 vota abstenime, 1 deputet nuk mori pjesë në votim.

Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.

Seanca e radhës do të njoftohet.

(Seanca u mbyll në orën 19:00)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin
Alket Hyseni

Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri